



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIAE PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

DREJTORIARAJONALEE ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 1238 Prot.

Fier, më 16.11. 2023

SHPALLJE Nr. 2

E VENDEVE TE LIRA PER PUNONJES TE NJESISESESHERBIMIT PSIKO-SOCIAL NE INSTITUCIONET PUBLIK TE ARSIMIT PARAUNIVERSITAR (IPAP) NE ZVAP NE VARESI TE DRAP FIER

Në zbatim të Ligjit nr.69 / 2012 “ Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë“ i ndryshuar, VKM nr.99, datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, Urdhërit nr.313 datë 20.10.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e njesisë së shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social”, i ndryshuar, shpall vendet e lira të punës për punonjës në njësinë e shërbimit psiko-social (**psikolog/punonjës-social**) në institucionet publike të arsimit parauniversitar IPAP, në ZVAP-të në varësi të DRAP Fier.

I. Kriteret për t’u punësuar në shërbimin psikosocial

A. Kërkesat e përgjithshme që duhen plotësuar për punësim në pozicionet e mësipërme janë:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi për të vepruar;
3. Të jetë në kushte shëndetësore të mira për të kryer detyrat përkatëse;
4. Të mos jetë dënuar për vepra penale dhe të mos ketë proces penal të hapurnë prokurori apo gjykatë;
5. Të mos jetë marrë më parë masë largimi nga punët e mëparshme dhe të mos ketë masa të tjera administrative apo vërejtje në fuqi.

B. Kërkesat e veçanta që duhen plotësuar për punësim në pozicionet e mësipërme janë:

1. Kandidati duhet të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
2. Të jetë pajisur me diplomën e ciklit të dytë, në fushën përkatëse;
3. Njohuri bazë në kompjuter;
4. Zotërimi i gjuhëve të huaja përbën avantazh (dëshmi,certifikata);
5. Aftësi komunikuese dhe punës në grup.

II. Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

A. Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Përshkrimi i edukimit dhe i karrierës profesionale- jetëshkrimin (Curriculum vitae), sipas shtojcës 3 të Urdhërit nr.313, datë 20.10.2020 (e detyrueshme);
2. Kërkesë për punësim në zyrën arsimore që dëshiron për pozicionin psikolog / punonjës social (e detyrueshme);
3. Raport mjekoligjor i tri muajve të fundit (i detyrueshëm);

4. Deklaratë për verifikimin e vërtetësisë së dokumentave të paraqitura nga kandidati sipas shtojcës 4 të Urdhërit nr.313 datë 20.10.2020 (e detyrueshme);
5. Formular vetëdeklarimi i gjendjes gjyqësore sipas shtojcës 5 të Urdhërit nr.313 datë 20.10.2020 (e detyrueshme);
6. Fotokopje e librezës së punës e noterizuar (nëse ka);
7. Kopje e njehsuar me origjinalin e diplomës/diplomave, vërtetimit/listës së notave të studimeve të larta (cikli i parë, cikli i dytë dhe diplomat e integruara të ciklit të dytë) ose të barazvlefshme me këto sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi (për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit (e detyrueshme);
8. Listë notash e noterizuar për nivelin bachelor dhe master (e detyrueshme);
9. Leje për ushtrimin individual të profesionit (licencë);
10. Kopje e njehsuar me origjinalin e arsimit shtesë dhe listës së notave si dhe certifikatave për gjuhët e huaja apo kualifikime të ndryshme;
11. Fotokopje e kartës së identitetit ose certifikatë personale (e detyrueshme);
12. Dëshmi penaliteti (e detyrueshme);
13. Nëse është i punësuar, vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi ose vetdeklarim në rastin kur nuk është i punësuar (detyrueshme).
- 14. Kualifikimi dhe vlerësimi i kandidatve do të bazohet në Urdhërit nr.313 datë 20.10.2020, i ndryshuar, kreu VII, pika 4**

B. Dokumentacioni i aplikimit dorëzohet nëpërmjet shërbimit postar në DRAP Fier përkatëse brenda afatit 17.11.2023- 22.11.2023.

- III. Vlerësimi i dokumentacionit të kandidatëve për psikolog /punonjës social do të kryhet nga komisioni në datën 23.11.2023.
- IV. Rezultatet paraprake e vlerësimit të dokumentacionit do të shpallen në faqet zyrtare të DRAP Fier në datë 24.11.2023.
- V. Ankimimet brenda datës 30.11.2023.
- VI. Rezultatet përfundimtare do të shpallen në datën 01.12.2023
- VII. Bazuar në renditjen përfundimtare, DRAP Fier do të ndjekë procedurat e emërimit sipas përcaktimeve të Urdhërit nr.313/2020 i ndryshuar.
- VIII. Në tabelën bashkëlidhur do të gjeni vendet e lira sipas ZVAP-ve përkatëse.



FLUTURA MEÇAJ

LISTA E VENDEVE TË LIRA PËR PROCEDURËN E KONKURIMIT PËR SHPS

Për publikim



Nr	Drap	Zvrap	Shkolla	Psikolog/P/Social	Kontrata me afat/ pa afat
1	Fier	Fier	PERIKLI IKONOMI	Psikolog	L.lindje 11.03.2024
2	Fier	Fier	LIRI GERO	Psikolog	L.lindje 31.01.2024
3	Fier	Fier	MARK DASHI	Psikolog	L.lindje 23.04.2024
4	Fier	Fier	Mustafa Hoxha	P.Social	Me Afat
5	Fier	Patos	9-vjeçare "Muhamet Shehu"	Psikolog	Me Afat
6	Fier	Roskovec	SHMB - "Didin Bishani" Kurjan	P.Social	Me Afat
7	Fier	Roskovec	9-vjeçare "7 Dëshmorët" Strum	Psikolog	Me Afat
8	Fier	Roskovec	9-vjeçare "5 Dëshmorët" Suk 1	P.Social	Me Afat
9	Fier	Mallakastër	"Hajredin Fratari" Fratar	P.Social	Me Afat
10	Fier	Mallakastër	9-vjeçare "Gjok Doçi"	Psikolog	Me Afat
11	Fier	Mallakastër	"Besëlidhja" Ballsh	P.Social	Me Afat
12	Fier	Mallakastër	"Ramiz Aranitasi" Aranitas	P.Social	Me Afat
13	Fier	Vlorë-Himarë	9-vjeçare Rilindja	P.Social	Me Afat
14	Fier	Vlorë-Himarë	9-vjeçare "Pano Nikolla Meniko"	Psikolog	Me Afat
15	Fier	Vlorë-Himarë	SHMB - "Qazim Pali "	Psikolog	Me Afat
16	Fier	Vlorë-Himarë	9-vjeçare "Lef Sallata"	Psikolog	Me Afat
17	Fier	Vlorë-Himarë	9-vjeçare "Jani Minga"	P.Social	Me Afat
18	Fier	Vlorë-Himarë	9-vjeçare "Jani Minga"	Psikolog	Me Afat
19	Fier	Vlorë-Himarë	SHMB - "Hasan Mëhilli "	P.Social	Me Afat
20	Fier	Vlorë-Himarë	SHMB - "Hysen Cino"	Psikolog	Me Afat
21	Fier	Selenicë	9-vjeçare "Eqerem Beqiri"	P.Social	Me Afat
22	Fier	Selenicë	Filo Ramadani	Psikolog	Me Afat
23	Fier	Tepelenë-Memaliaj	Gjimnazi "Sali Nivica" Memaliaj	Psikolog	Me Afat
24	Fier	Tepelenë-Memaliaj	9-vjeçare "Avni Rustemi"	Psikolog	Me Afat
25	Fier	Tepelenë-Memaliaj	SHMB- "Adem Alushi" Lulëzim	P.Social	Me Afat
26	Fier	Tepelenë-Memaliaj	SHMB- "Xhevit Çela" Izvor	P.Social	Me Afat
27	Fier	Tepelenë-Memaliaj	9-vjeçare "Memo Nexhipi" Dukaj	P.Social	Me Afat
28	Fier	Përmet-Këlcyrë	SHMB - "Lumo Pavari" Sukë	P.Social	Me Afat
29	Fier	Gjirokastër	9-vjeçare "Urani Rumbo"	Psikolog	Me Afat
30	Fier	Gjirokastër	SHMB - "Muhamet Gjollështa"	Psikolog	Me Afat
31	Fier	Gjirokastër	9-vjeçare "Naim Frashëri"	P.Social	Me Afat
32	Fier	Sarandë	9-vjeçare "Adem Sheme	P.Social	L.lindje 03.06.2024
33	Fier	Sarandë	"Bido Sejko"	Psikolog	Me Afat
34	Fier	Sarandë	9-vjeçare "Kosta Çavo"	Psikolog	Me Afat
35	Fier	Sarandë	9-vjeçare "Shefqet Sulejmani"	P.Social	Me Afat
36	Fier	Sarandë	Mehmet Xhaferi	Psikolog	Me Afat
37	Fier	Sarandë	5 Dëshmorët	Psikolog	Me Afat
38	Fier	Finiq-Dropull	Shkolla 9-Vjeçare Mesopotam	Psikolog	Me Afat
39	Fier	Finiq-Dropull	SHMB - Derviçan	Psikolog	Me Afat